



**RAPORTIMI FINANCIAR I ADMINISTRIMIT TË BUXHETIT
TË KOMUNËS SË SUHAREKËSPËR PERIUDHËN
JANAR – DHJETOR 2021**

Suharekë – Janar 2022



Duke u bazuar në nenin 12 paragrafi 2 pika (c) të Ligjit Nr-03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008”, nenin 29 dhe 54 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, të datës 04.11.2008, e në mbështetje të nenit 45 paragrafi 4, lidhur me nenin 46 paragrafi 2, të Ligjit Nr-03/L-048, për menaxhimin e financave publike te përgjithshme, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 27/2008”, Kuvendi i Komunës në Suharekë, në mbledhjen e mbajtur me datën, ----- miratoi këtë;

Projekt-V E N D I M

Për miratimin e llogarisë përfundimtare të të ardhurave dhe të shpenzimeve të buxhetit të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor 2021**.

Neni 1

Me këtë vendim miratohet llogaria përfundimtare e Komunës së Suharekës për periudhën **Janar – Dhjetor të vitit 2021**, i cila përmban të dhënat si më poshtë:

Nr.Rd	Mjetet e Komunës	Realizimi 2021	Përqindja
1	Të ardhurat e gjithëmbarshme	18,064,308.44	100.00%
2	Të dalurat e gjithëmbarshme	16,922,196.86	93.68%
3	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave	(1,142,111.58)	-6.32%
a	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave B.R.K	210,499.91	1.17%
b	Teprica e Financimeve nga huamarret	31.60	0.00%
c	Teprica nga donacionet	7,766.86	0.04%
d	Teprica e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetanake 2021	768,422.28	4.25%
e	Tepric e të hyrave ndaj të dalurave Mjet.vetanake 2019	155,390.93	0.86%
	Teprica për bartje në vitin 2021	923,813.21	100.00%

Neni 2

Të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara si dhe teprica e të ardhurave në raport me shpenzimet e administruara te përcaktuara si në nenin 1 të këtij vendimi, janë shpalosur në bilancin e mjeteve të Komunës së Suharekës për periudhën **Janar–Dhjetor** të vitit 2021 dhe raporti si i tillë është pjesë përbërëse e këtij vendimi.

Neni 3

Realizimi dhe zbatimi i këtij vendimi do të bëhet në pajtim me dispozita e Ligjeve në fuqi dhe Rregulloren e procedurës së përgjithshme për menaxhimin financiar të komunës së Suharekës.

Neni 4

Për zbatimin-implementimin e këtij vendimi kujdeset qeveria lokale e Komunës së Suharekës.

Neni 5

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr. 03/L-040 për vetëqeverisjen lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008” dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, Nr. 10/2019, për procedurat e hartimit dhe publikimin e akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 të datës 23.10.2021 dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË

01-Nr-_____
 Me datë _____

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI

R A P O R T I

I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT PËR PERIUDHËN JANAR –DHJETOR 2021

Ky është raporti **ikatërt** i Administrimit të Buxhetit për periudhën **Janar–Dhjetor për vitin fiskal 2021** i cili i prezantohet Kuvendit të Komunës dhe të cilin buxhet fillestar e ka miratuar në mbledhjen e vetë të mbajtur me 26.09.2020. Prezantimi i administrimit të buxhetit për vitin fiskal, lidhur me ecurinë e ekzekutimit është konsistent me nenin 46.2” raportimet buxhetore” të LMFPP të vitit 2008.

➤ **Buxheti komunal përbëhet prej këtyre burimeve kryesore dhe atë:**

- Të hyrat nga Grandi i Qeverisë (Buxhetit të Republikës së Kosovës),
- Të hyrat nga Mjetet Vetanake të Komunës
- Financimet nga Huamarrjet si dhe
- Të hyrat nga Grantet e donatorëve.

Emërtimi i Të	Buxheti në SIMFK	%	Buxheti i Alokuar	%	%
Hyrave	I - XII - 2021	Përqindja	I - XII - 2021	Përqindja	Përqindja
1	2	3	4	5	6=(4:2)
Grant Qev.për Paga & Meditje	8,710,886.16	58.94	8,710,886.16	58.94%	100.00%
Grant Qev. Mallra & Shërbime	1,620,113.00	10.96	1,620,113.00	10.96%	100.00%
Grant Qever.për Shpz.Komunale	256,449.00	1.74	256,449.00	1.74%	100.00%
Grant Qever.për Subvencione	58,000.00	0.39	58,000.00	0.39%	100.00%
Grant Qever.Investime Kapitale	4,133,220.00	27.97	4,133,220.00	27.97%	100.00%
TOTAL:Mjetet e grantit Qev.	14,778,668.16	100.00%	14,778,668.16	100.00%	100.00%
Mjetet Vetanake 2021	1,812,956.00	69.96	1,812,956.00	69.96%	100.00%
Mjetet Vetanake 2020-Bartja	778,413.42	30.04	778,413.42	30.04%	100.00%
TOTAL:Mjetet Vetanake	2,591,369.42	100.00%	2,591,369.42	100.00%	100.00%
Finaci.nga Huamarrja Mallra&shërbim	45,387.00	48.36	45,387.00	48.38%	100.00%
Finaci.nga Huamarrja Projekte Kapital	21,431.00	22.84	21,399.80	22.81%	99.85%
Finac.nga huamarrja Paga & Meditj	27,026.64	11.95	27,026.64	11.95%	100.00%
Total :Huamarrja	93,844.64	100.00%	93,813.44	100.00%	99.97%
Donacionet:	226,195.82	100.00%	226,195.82	100.00%	100.00%
Total Komunal:	17,690,078.04	100.00%	17,690,046.84	100.00%	100.00%

- Të hyrat nga Granti Qeveritar mbështetur në bazë të alokimeve gjatë vitit fiskal 2021 të proceduar për kategoritë e shpenzimeve si për mallra e shërbime,pagave dhe mëditjeve,shpenzime komunale,si dhe për shpenzime kapitale.Pjesëmarrja e këtyre kategorive ekonomike në buxhetin e alokuar të dedikuar për shpenzim është me sa vijon:
 - Paga dhe meditje marrin pjesë me 58.94%,
 - Mallra dhe shërbimet me 10.96%
 - Shpenzime komunale me 1.74%
 - Subvencione & transfere me 0.39% si dhe
 - Investimet kapitale me 27.97% .
- Prioritet me rëndësi për Komunen është fokusimi i performances në të hyrat vetanake.Të hyrat tona vetanake japin një qëndrueshmëri buxhetit komunal, gjithashtu edhe Komunës në përgjithësi,mirpo gjatë vitit raportues Të Hyrat Vetanake u reaziuan si dhe u tejkaluan sipas planifikimit si asnjëherë më parë në masen prej 2.79%.
- Mbështetur në të dhënat e specifikuar më lartë, shihet qartë se Të hyrat vetanake përfshirë edhe participimet për këtë periudhë të raportimit financiar koeficienti i realizimit në raport me

parashikimit e buxhetit fillestar ku të hyrat vetanake për vitin fiskal 2021 janë alokuar në përqindje prej 100.00% përkatësisht të hyrat e grumbulluara për periudhën Janar- Nëntor të vitit 2021 kanë qenë **1,812,956.00 €**, ndërsa të hyrat e mbledhura në muajin Dhjetor në vlerë prej **374,230.40€** të vitit 2021 e që në total janë **(1,812,956.00 + 374,230.40)=2,187,186.40€** janë alokuar në muajin Janar të vitit 2022,e të cilat do të shfrytëzohen për projekte kapitale të mbetura nga plani buxhetor për investime kapitale të vitit 2022.

- Këtu vlen të përmendet se të hyrat e tërësishme të realizuar nga Granti Qeverisës i Buxhetit të Republikës së Kosovës, janë alokuar për **“Paga dhe mëditje”** të punëtorëve vlera prej **8,8,710,886.10€**, për **“Mallra dhe shërbime”** vlera prej **1,620,113.00€**,për**“Shpenzime komunale** “në shumë prej **256,449.00 €** si dhe për **”Investime kapitale“**në vlerë prej **4,133,220.00€**.
- Tëhyrat vetanake të bartura nga viti fiskal 2020,në vitin fiskal 2021 janë alokuar në total 100,00% nga departamenti i Thesarit -Ministria e Financave Punës dhe transfereve në Prishtinë.

A. TABELA E ALOKIMEVE TË MJETEVE BUXHETORE JANAR – DHJETOR 2021 FONDI BURIMOR (10) BUXHETI I ALOKUAR

Emri i programit	Alokimet	Alokimet	Alokimet	Alokimet	Alokimet	Alokimet
	Paga &Meditje	Mall & Sherb	Subvencio.	Komunalit	Sh.Jofinanciar	TOTOL:
	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021
1	2	3	4	5	6	7
Zyra e Kryetarit	141,032.82	26,000.00	-	-		167,032.82
Zyra e Kuvendit	101,354.70	22,000.00	-	-	-	123,354.70
Administrata & Personel	182,224.14	156,000.00	-	-	-	338,224.14
Inspekcioni	64,777.29	10,000.00	-	-	-	74,777.29
Buxhet dhe Financa	153,134.15	36,000.00	-	-	-	189,134.15
Sherb.Pub.Mbrojtja Civil	165,720.14	60,000.00	58,000.00	130,000.00	2,806,540.00	3,220,260.14
Zyra e Komuniteteve	6,220.70	2,000.00				8,220.70
Bujqësia & Pylltari	59,075.74	20,000.00	-	-	453,000.00	532,075.74
Kadaster & Gjeodezi	64,819.41	9,000.00	-	-	-	73,819.41
Urbanizmi e Planifikimi	37,653.26	15,000.00	-	-	155,000.00	207,653.26
Kulturë, Rini,Sport e Me	80,982.23	35,000.00	-	-	145,000.00	260,982.23
Administrata & Shëndetë	25,925.74	10,000.00	-	-	-	35,925.74
Shëndetsia -QKMF	1,144,258.79	575,000.00	-	45,949.00	379,100.00	2,144,307.79
Shërbimet Sociale-QPS	74,317.28	11,000.00	-	2,500.00	-	87,817.28
Administrata-Arsimi	68,983.52	193,000.00	-	-	118,000.00	379,983.52
Arsimi Parafillor-Qerdhe	88,693.00	9,157.00	-	3,000.00	-	100,850.00
Arsimi Fillor	4,874,217.23	272,189.00	-	50,000.00	76,580.00	5,272,986.23
Arsimi Mesem	1,377,496.02	158,767.00	-	25,000.00	-	1,561,263.02
T O T A L :	8,710,886.16	1,620,113.00	58,000.00	256,449.00	4,133,220.00	14,778,668.16

- **Tabela A-** tregon qartë alokimin e mjeteve nga buxheti i Republikës së Kosovës,sipas programeve e kategorive të shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2021.

Tabela- B ALOKIMET E MJETEVE VETANAKE JANAR – DHJETOR 2021

Emri i programit	Alokimet e	Alokimet	Alokimet	Alokimet	Alokimet	Alokimet
	Pagave	Mall. e Shërb	Shpenz.Komu	Subvencioneve	Jofinanciare	TOTAL:
	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021
1	2	3	4	5	6	7
Zyra e Kryetarit	-	3,000.00	-	65,000.00	-	68,000.00
Zyra e Kuvendit	-	13,000.00				13,000.00
Administrata & Persone	-	94,000.00				94,000.00
Buxhet dhe Financa	-	10,000.00				10,000.00
Sherb.Pub.Mbrojtja Civi	-	35,000.00	50,000.00	-	515,156.00	600,156.00
Bujqësia & Pylltari	-	20,000.00	-	100,000.00	67,800.00	187,800.00
Kadaster & Gjeodezi	-	5,000.00	-	-	-	5,000.00
Urbanizmi e Planifikimi	-	15,000.00	-	-	25,000.00	40,000.00
Kulturë, Rini, Sport e Merg	-	27,000.00	-	100,000.00	60,000.00	187,000.00
Administrata & Shëndet	-	14,000.00	-	60,000.00	-	74,000.00
Shëndetsia -QKMF	75,000.00	82,000.00	-	-	35,000.00	192,000.00
Shërbimet Sociale-QPS	-	3,000.00	-	-	-	3,000.00
Administrata-Arsimi	-	145,000.00	30,000.00	100,000.00	32,000.00	307,000.00
Arsimi Parafillor-Qerdhe	-	-	12,000.00	-	-	12,000.00
Arsimi Mesem	-	10,000.00	10,000.00	-	-	20,000.00
T O T A L :	75,000.00	476,000.00	102,000.00	425,000.00	734,956.00	1,812,956.00



➤ **Tabela B** – tregon qartë alokimin e mjeteve vetanke të vitit 2021, të grumbulluara për periudhën **Janar-Nëntor 2021**, kurse pjesa e mjeteve të grumbulluara gjatë muajit dhjetor 2021 në vlerë prej **374,230.40€** janë mjete të cilat janë grumbulluar e të citat do të barten në vitin e ardhshëm fiskal 2022 për shpenzim të mëtejshëm sipas programeve dhe nënprogrameve buxhetore të Komunës .

TABELA C. ALOKIMET E MJETET VETANAKE TË PERCJELLURA NGA VITI viti 2020 në vitin fiskal 2021

Emri i Programit	Alokimet e	Alokimet	Alokimet	Alokimet	Alokimet	Alokimi
	Paga& Medit	Mall & Sherb	Komunalit	Subvencion	Invest.Kapitale	TOTAL :
	I-IX-2021	I-IX-2021	I-IX-2021	I-IX-2021	I-IX-2021	I-IX-2021
1	2	3	4	5	6	7
Zyra e Kryetarit		1,995.21				1,995.21
Zyra e Kuvendit		7,324.90				7,324.90
Administrata & Presoneli		22,792.70				22,792.70
Inspeksioni		-			11,140.37	11,140.37
Buxhet dhe Financa		4,660.25				4,660.25
Sherb.Publike dhe Emergj.		18,442.15	-	-	181,722.94	200,165.09
Zyra e Komuniteteve		-				-
Bujqësi & Pylltari e Zhvll.		27,977.86	-	-	44,701.11	72,678.97
Kadaster & Gjeodezi		-				-
Urbanizmi e Planifikimi		6,138.20			91,509.07	97,647.27
Kulturë,Rini, Sport e Merg		-	-	80,000.00	58,296.07	138,296.07
Shëndetsia -Mirqenje Sociale	50,000.00	32,822.26	-	13,308.00	-	96,130.26
Arsimi dhe Shkenca	6,000.00	12,201.85	29,733.58	40,119.00	37,527.90	125,582.33
T O T A L :	56,000.00	134,355.38	29,733.58	133,427.00	424,897.46	778,413.42

➤ **Tabela C** - tregon alokimet e mjeteve vetanake të vitit 2020 të përcjellura në vitin 2021, për **shfrytëzim** dhe atë sipas programeve dhe kategorive të shpenzimeve .

**A - PASQYRA E TË HYRAVE VETANAKE SIPAS NJËSIVE BUXHETORE TË REALIZUARA
DERI ME 31.12.2021**

Kategorit e Të hyrave Vetanke	Realizuar 2020	Realizuar 2021	Planifikuar 2021	Progresi në %	Progresi në %
1	2	3	4	5=3:2	6=4:3
16312 - ADMINISTRATA	78,055.37	86,154.00	138,140.00	110.38%	62.37%
50016 - TAX CER.LINDJES,KUROR.E TJERA	50,072.50	63,304.00	104,000.00	126.42%	60.87%
50017 - TAX VERIFIKIM DOK.TË NDRY SHME	27,982.87	22,850.00	34,140.00	81.66%	66.93%
16623 - INSPEKSIONI	5,913.00	6,524.00	11,000.00	110.33%	59.31%
50501 - INSPEKTIMI ARTIKUJVE USHQIMOR	5,913.00	6,524.00	11,000.00	110.33%	59.31%
17512 - BUXHETIMI	1,015,715.17	1,361,730.57	1,337,816.00	134.07%	101.79%
40110 - TATIM NË PRONË	681,365.48	968,555.51	832,746.00	142.15%	116.31%
50001 - TAX REGJISTRIMI I AUTOMJETEVE	128,720.00	142,000.00	156,850.00	110.32%	90.53%
50006 - TAX REGJISTRIM BIZNESI	123,723.12	157,467.96	165,000.00	127.27%	95.44%
50405 - SHFRYTEZ.I PRONES PUBL.-RENTA	54,743.67	45,207.00	43,220.00	82.58%	104.60%
50408 - QIRAJA NGA OBJEKTET PUBLIKE	27,162.90	48,500.10	140,000.00	178.55%	34.64%
65060 - SHËRBIMET KADASTRALE	88,773.23	115,866.50	45,000.00	130.52%	257.48%
50504 - TAX PER MATJEN TOKES NE TEREN	88,773.23	115,866.50	45,000.00	130.52%	257.48%
66365 - PLANIF.URBAN.INSPEKSIONI	226,952.64	171,034.23	140,000.00	75.36%	122.17%
50009 - TAX PËR LEJE NDËRTIMI	226,952.64	171,034.23	140,000.00	75.36%	122.17%
73750 - SHËR. E KUJD. PRI. SHËNDETËSOR	55,180.50	80,702.90	60,000.00	146.25%	134.50%
50409 - PARTICIPIMET	55,180.50	80,702.90	60,000.00	146.25%	134.50%
85012 - SHËRBIMET KULTURORE	13,998.00	13,891.50	31,000.00	99.24%	44.81%
50018 - TAX E FOTOKOPJ.TE DOKUM.	2,170.00	2,427.50	3,000.00	111.87%	80.92%
50019 - TAX TJERA ADMINISTRATIVE	11,828.00	11,464.00	28,000.00	96.92%	40.94%
92430 - ARSIMI PARAFI & QERDHET	17,681.00	26,815.05	31,000.00	151.66%	86.50%
50409 - PARTICIPIMET	17,681.00	26,815.05	31,000.00	151.66%	86.50%
94531 - M.TEKNIKE S.LUARASI	1,179.00	899.50	19,000.00	76.29%	4.73%
50409 - PARTICIPIMET	1,179.00	899.50	19,000.00	76.29%	4.73%
TOTAL :TË HYRAT VETANAKE	1,503,447.91	1,863,618.25	1,812,956.00	123.96%	102.79%
50409 - DENIMET E TRAFIKUTT	202,960.50	296,018.15	-	145.85%	#DIV/0!
50409 - DENIMET E GJKATAVE	19,475.00	27,550.00	-	141.46%	#DIV/0!
50409 - DENIMET E PYJET	654.37	0.00	-	0.00%	#DIV/0!
TOTAL: DENIMET	223,089.87	323,568.15	0.00	145.04%	#DIV/0!
TOTAL :TË HYRAT VETANAKE KOMUNALE	1,726,537.78	2,187,186.40	1,812,956.00	126.68%	120.64%

- Bazuar në të dhënat e shpalosura në pasqyrën e Të Hyrave Vetanake ,të hyrat që burojnë nga kategoria e tatimit në pronë kanë një pjesëmarrje prej **51.97 %** në bruto totalin e të hyrave vetanake për vitin fiskal 2021. **Tatimi në pronë** krahasuar me vitin e kaluar është realizuar më masën për 42.15% më shumë ose shprehur në vlerë për (968,555.51-(minus) 681,366.48)= **+287,890.03€,më shumë se periudha e njëjtë e vitit të kaluar ose 133,809.51 më shumë se planifikimi i tyre.**
- Sipas planifikimit ky tatim është realizuar në masën 16.31% më shumë se plani buxhetor për vitin 2021. Megjithatë këto të hyra bëjnë pjesë në vendin e parë të Të Hyrave Vetanake që përbëjnë buxhetin e Komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2021.
- Të hyrat nga administrata,si të hyrat për çertifikatat lindjes,kurorëzimit dhe certifikata të tjera kanë ramje sipas planit ato janë realizuar në masën prej vetem 62.37%.Të hyrat nga shërbimet kadastrale janë rritur në masën prej 30.52% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ,kurse sipas planifikimit ato janë realizuar në masën prej 157.48% më shumë krahasuar me planin buxhetor.
- Urbanizmi dhe Planifikimi kanë realizuar 24.64% më pak mjete se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar,kurse krahasuar me planifikimin ata kanë realizuar 22.17% më shumë se që kishin planifikuar për vitin fikal 2021.

- Të hyrat nga Shëndetësia (QKMF) marrin pjesë me 4.33 %,ose krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ajo ka rritje prej 46.25% më shumë,kurse krahasuar me planifikimin ajo ka arritur të mbledhë 34.50% më shumë nga masa se planifikuar.
- Shërbimet kulturore,Rini e Sport krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar kanë realizuar 99.24% ose për 0.76% më pakë,kurse sipas planifikimit për vitin 2021 ajo ka realizuar masën prej vetëm 44.81% të planit buxhetor.
- Arsimi parashkollor dhe i mesëm merr pjesë me 1.48% në Të Hyrat Vetanake Komunale ose arsimi parafillor ka realizuar 86.50% të planifikimit kurse ai i mesëm vetëm 4.73%.
- **Nga pasqyra e Të Hyrave Vetanake të realizuar në vitin 2021 shihet se të hyrat vetanake janë realizuar për 23.96% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.**
- **Të Hyrat Vetanake sipas parashikimit të planit për vitin 2021 janë realizuar dhe shprehur në përqindje në masen prej 2.79% më shumë se planifikimi për vitin 2021.**

❖ PASQYRA E BRÛTO SHPENZIMEVE KOMUNALE
Janar – Dhjetor 2021

Nr. Rd.	Emërtimi i Shpenzimeve	Buxheti i Alokuar I-XII-2021	% Përqindja	Realizi&Shpenzimi I-XII-2021	Pjesemar në %	Progresi %
1	2	3	4	5	6	7=(5:3)
1	Pagat & Meditjet	8,710,886.16	58.94%	8,710,886.16	59.79%	100.00%
2	Mallërat e Shërbimet	1,620,113.00	10.96%	1,584,259.26	10.87%	97.79%
3	Shpenzimet Komunale	256,449.00	1.74%	256,418.76	1.76%	99.99%
4	Subvenc.& Transfere 2021	58,000.00	1.40%	58,000.00	1.47%	100.00%
5	Pasurit Jo financiare	4,133,220.00	27.97%	3,958,604.07	27.17%	95.78%
	TOTAL:Buxhet i K.K.	14,778,668.16	100.00%	14,568,168.25	100.00%	98.58%
1	Pagat & Meditjet THV 2021	75,000.00	10.20%	75,000.00	15.72%	100.00%
2	Mallrat & Shërbimet THV.2021	476,000.00	26.26%	400,294.49	28.21%	84.10%
3	Shpenzimet Komunale THV.2021	102,000.00	5.63%	49,514.02	3.49%	48.54%
4	Subvenc.& Transfere THV.2021	425,000.00	23.44%	416,898.00	29.38%	98.09%
5	Pasuritë Jo financiare THV.2021	734,956.00	40.54%	477,057.61	33.62%	64.91%
	TOTAL:Mjete Vetanake 2021	1,812,956.00	100.00%	1,418,764.12	100.00%	78.26%
1	Pagat & Meditjet THV 2020	56,000.00	13.18%	56,000.00	20.08%	100.00%
2	Mallërat & Shërbimet THV.2020	134,355.38	31.62%	128,811.12	46.19%	95.87%
3	Shpenzimet Komunale THV.2020	29,733.58	3.82%	25,948.96	4.17%	87.27%
4	Subvenc.& Transferet THV.2020	133,427.00	17.14%	133,400.00	21.41%	99.98%
5	Pasuritë Jo financiare THV.2020	424,897.46	54.59%	278,862.41	44.76%	65.63%
	TOTAL:Mjetet Vetanake 2020	778,413.42	100.00%	623,022.49	100.00%	80.04%
1	Financimet nga Huamarrjet 2021	93,844.64	100.00%	93,813.04	100.00%	99.97%
	Total: Financimet nga Huamarrjet	93,844.64	41.49%	93,813.04	100.00%	99.97%
1	Sh.jo financiare donatorët 2021	226,195.82	100.00%	218,428.96	100.00%	96.57%
	TOTAL:Mjete e Donatorëve	226,195.82	100.00%	218,428.96	100.00%	96.57%
	TOTAL KOMUNAL:	17,690,078.04	100.00%	16,922,196.86	100.00%	95.66%

- **Sipas listave të pagave të punëtorëve, mesatarja e bruto pagave për një muaj, për një punëtor të punësuar në Komunë është 561.61€ . Staf i Komunës përbëhet prej 1316 punëtorëve të përhershëm.** Në totalin e pagave janë llogaritur edhe **pagat shitesë pas orarit të punës** si dhe ditëve të vikendit (inspekcioni dhe QKMF-ja.)
- **Nga tabela e sipërme shihet qartë se Komuna e Suharekës gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2021 ka krijuar shpenzime apo janë shpenzuar mjete në shumë prej 16,922,196.86€.** Ku nga buxheti i Republikës së Kosovës janë shpenzuar shuma prej **14,568,168.25€**, apo nga kjo shumë **59.70%**, për **“paga dhe meditje”**,apo shuma prej **8,710,886.16€** ,për **“mallra dhe shërbime 10.87%** apo vlera prej **1,584,259.26€**, për **“shpenzime komunale” 1.76%** apo **256,418.76€**, për **“Subvencione&Transfere”**

shumaprej 58,000.00€ si dhe për “Investime kapitale 27.17% apo shprehur në vlerë prej 3,958,604.07€.

- Shpenzimet nga buxheti i mjeteve vetanake të vitit 2021 janë në shumë prej 1,418,764.12 €, dhe atë për “Paga & medijtje” shuma prej 75,000.00€ , për “mallra dhe sherbime” shuma prej 400,294.490€, për “shpenzime komunale shuma prej 49,514.02€, për “subvencione dhe transfere” shuma prej 416,898.00€ si dhe për “Investime kapitale” është shpenzuar shuma prej 477,057.61€ nga këto mjete të destinuar për shpenzim.
- Shpenzimet e mjeteve vetanake të vitit 2020 të përcjellura në vitin fiskal 2021 janë alokuar në shumë prej 778,413.42€, ku këto mjete janë alokuar në fillim të muajit mars të vitit 2021 si dhe këto mjete janë shpenzuar në vlerë prej 623,022.49€ ose janë realizuar në masen prej 80.04%, sipas kategorive të shpenzimeve të paraqitura në tabelen e lartëshenuar.

❖ SHPENZIMET JANAR – DHJETOR 2021 SIPAS BURIMEVE TË FINANCIMIT (10)- SHPENZIMET NGA BUXHETI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Emërtimi i Programeve	Buxh.Fillest I-XII-2021	Pagat & Medijet	Mallrat & Sherbimet	Shpenzim. Komunalie	Subvencione Transfere	Shpenzimet Kapitale	TOTAL: Shpenzuar
Zyra e Kryetarit	167,032.00	141,032.82	25,871.91	-	-	-	166,904.73
Zyra e Kuvendit	123,354.00	101,354.70	21,992.84	-	-	-	123,347.54
Administrata & Personeli	338,224.00	182,224.14	155,002.00	-	-	-	337,226.14
Buxhet dhe Financa	189,134.00	153,134.15	35,835.61	-	-	-	188,969.76
Inspekcioni	74,777.00	64,777.29	8,668.26	-	-	-	73,445.55
Sherb.Publike Mbr.Civile Em	3,220,260.00	165,720.14	59,859.98	129,999.95	58,000.00	2,754,427.41	3,168,007.48
Zyra për Kthim & Komunitete	8,220.00	6,220.70	2,000.00	-	-	-	8,220.70
Bujqësia & Pyltari Zhv.Rural	532,075.00	59,075.74	15,318.01	-	-	411,947.20	486,340.95
Kadaster & Gjeodezi	73,819.00	64,819.41	8,522.88	-	-	-	73,342.29
Urbanizmi & Planifikimi	207,653.00	37,653.26	13,869.08	-	-	154,998.35	206,520.69
Kulturë, Rini, Sport e Mërg.	260,989.00	80,982.23	34,045.79	-	-	144,603.96	259,631.98
Administrata & Shëndetësis	35,925.00	25,925.74	9,621.01	-	-	-	35,546.75
Sherb.Kujd.Primar(QKMF)	2,144,307.00	1,144,258.79	573,225.77	45,949.00	-	336,040.38	2,099,473.94
Mirëqenja Sociale(QPS)	87,817.00	74,317.28	10,009.76	2,500.00	-	-	86,827.04
Administrata & Arsimi	379,983.00	68,983.52	188,915.68	-	-	102,287.19	360,186.39
Arsimi Parafillor-Qerdhet	100,850.00	88,693.00	8,278.55	2,991.81	-	-	99,963.36
Arsimi Fillor	5,272,986.00	4,874,217.23	269,828.18	49,983.81	-	54,299.58	5,248,328.80
Arsimi i Mesem	1,561,263.00	1,377,496.02	143,393.95	24,994.19	-	-	1,545,884.16
TOTAL:	14,778,668.00	8,710,886.16	1,584,259.26	256,418.76	58,000.00	3,958,604.07	14,568,168.25

**❖ SHPENZIMET E MJETEVE VETANAKE JANAR - DHJETOR 2021
FONDI BURIMOR VETANAK (21)**

Emërtimi	Buxh.Fillestar	Paga &	Mallrat &	Shpenzime	Subvencione	Shpenzimet	TOTAL:
Programit	I-XII-2021	Meditje	Sherbimet	Komunale	Transferet	Kapitale	Shpenzuar
1	2	3	5	7	8	9	10
Zyra e Kryetarit	68,000.00	-	2,909.39	-	64,908.00	-	67,817.39
Administrata & Personeli	94,000.00	-	93,721.14	-	-	-	93,721.14
Buxhet e financa	10,000.00	-	3,911.49	-	-	-	3,911.49
Zyra e Kuvendit Komunal	13,000.00	-	8,933.33	-	-	-	8,933.33
Shërb.Publike &Emrgjente	600,156.00	-	35,000.00	49,514.02	-	405,335.81	489,849.83
Bujqësi & Pyll.Zhvillim Rur	187,800.00	-	3,360.00	-	98,650.00	35,960.90	137,970.90
Kadaster &Gjeodezi	5,000.00	-	5,000.00	-	-	-	5,000.00
Urbanizmi &Planifikimi	40,000.00	-	13,748.47	-	-	-	13,748.47
Kultur Rini Sport e Mergat	187,000.00	-	14,145.91	-	100,000.00	21,394.20	135,540.11
Administrata & Shëndetësi	74,000.00	-	11,611.08	-	60,000.00	-	71,611.08
Sherb.Kujd.Primar(QKMF)	192,000.00	75,000.00	79,999.50	-	-	9,366.70	164,366.20
Sherb.Sociale-QPS-ja	3,000.00	-	2,968.30	-	-	-	2,968.30
Administrata & Arsimi	307,000.00	-	124,985.88	-	93,340.00	5,000.00	223,325.88
Arsimi Parafillor-Qerdhet	12,000.00	-	-	-	-	-	-
Arsimi i Mesem	20,000.00	-	-	-	-	-	-
T O T A L :	1,812,956.00	75,000.00	400,294.49	49,514.02	416,898.00	477,057.61	1,418,764.12

**❖ SHPENZIMET E MJETEVE VETANAKE JANAR- DHJETOR 2021
TË PËRCJELLURA NGA VITI 2020 FONDI BURIMOR(22)**

Emërtimi	Buxh.Fillesta	Paga& medit	Mall.&Sher	Komunali	Subvencion	I.Kapitale	TOTAL:
Programit	I-XII-2020	I-XII-2020	I-XII/2020	I-XII/2020	& transfer	I-XII/2020	Shpenzimet
1	2		5			8	9
Zyra e Kryetarit	1,995.21	-	1,976.85				1,976.85
Administrata&Personeli	22,792.70	-	22,492.70				22,492.70
Zyra e Kuvendit Komunal	7,324.90	-	7,310.37				7,310.37
Inspekcioni	11,140.37	-	-	-	-	1,129.40	1,129.40
Bexhet dhe Financa	4,660.25	-	4,660.08	-	-	-	4,660.08
Shërbimet Publike Emergj	200,165.09	-	18,429.40	-	-	146,452.42	164,881.82
Bujqësi & Pylltari	72,678.97	-	27,975.00	-	-	42,335.00	70,310.00
Kadaster & Gjeodezi	-	-					-
Urbanizm &Planifikik	97,647.27	-	957.00	-	-	33,559.72	34,516.72
Kulturë,Rini e Sport e Marg	138,296.07	-	-	-	80,000.00	26,599.46	106,599.46
Shërbi.e Kujdesit Primar-QKMF	96,130.26	50,000.00	32,813.54	-	13,300.00	-	96,113.54
Arsimi &Shkenca	125,582.33	6,000.00	12,196.18	25,948.96	40,100.00	28,786.41	113,031.55
T O T A L :	778,413.42	56,000.00	128,811.12	25,948.96	133,400.00	278,862.41	623,022.49

- Kategoria e të hyrave vetanake të cilat përcillen nga viti 2020 në vitin 2021 janë bartur 100,00 % nga MFPT -Departamenti i Thesarit. Pasi që këto mjete janë percjellë nga **Ministria e Financave Punës dhe Transfereve ,Departamenti i Buxhetit dhe Thesarit në vitin 2021 por që janë shfrytëzuar në vleren prej 623,022.49€ e që pjesa tjetër ka mbetur për tu bartur në vitin fiskal 2022 për shpenzim të mëtejshëm.**

❖ SHPENZIMET SIPAS PROGRAMEVE – DREJTORIVE

1. ZYRA E KRYETARIT

Nr	Emërtimi i	Shpenzuar	Buxh.Filles	Buxh Alokua	Shpenzuar	Progresi	Progresi	Progresi
Rd	Shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	9=6:5
1.1	Pagat dhe Shtesa	144,865.54	141,032.82	141,032.82	141,032.82	97.35%	100.00%	100.00%
1.2	Mallrat & Sherbimet	25,298.17	26,000.00	26,000.00	25,871.91	102.27%	99.51%	99.51%
1.3	Subvenc.&Trans.2021	25,000.00	-	-	-	0.00%	#DIV/0!	#DIV/0!
1.4	Mallrat & Sherb.THV 2021	957.93	3,000.00	3,000.00	2,909.39	303.72%	96.98%	96.98%
1.5	Subvenc.&Trans.2020	65,000.00	65,000.00	65,000.00	64,908.00	99.86%	99.86%	99.86%
1.6	Mallrat & Sherb.THV 2020	-	1,995.21	1,995.21	1,976.85	#DIV/0!	99.08%	99.08%
	TOTAL:	261,121.64	237,028.03	237,028.03	236,698.97	90.65%	99.86%	99.86%

- Zyra e Kryetarit Buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020,buxhetin e saj e ka shfrytëzuar për 90.65% .Buxheti fillestar i vitit 2021 është shfrytëzuar në masën prej 99.86% si dhe krahasuar me buxhetin e alokuar – për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2021 ai është shpenzuar në masën 99.86% ,ose për 0.14% më pakë se buxheti i dedikuar për shpenzim.

2. ZYRA E KUVNDIT KOMUNAL

Nr	Emërtimi i	Shpenzuar	Buxheti Fill	Buxh Alokua	Shpenzuar	Progresi	Progresi	Progresi
Rd	Shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	9=6:5
1.1	Pagat dhe shtesa	102,822.39	101,354.70	101,354.70	101,354.70	98.57%	100.00%	100.00%
1.2	Mallrat & Sherbimet	14,789.52	22,000.00	22,000.00	21,992.84	148.71%	99.97%	99.97%
1.3	Mall. & Sherb.THV 2021	6,103.00	13,000.00	13,000.00	8,933.33	146.38%	68.72%	68.72%
1.4	Mallrat & Sherbime 2019	-	7,324.90	7,324.90	7,310.37	#DIV/0!	99.80%	99.80%
	TOTAL:	123,714.91	143,679.60	143,679.60	139,591.24	112.83%	97.15%	97.15%

- Zyra e Kuvendit buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar 12.83% më shumë,kurse sipas buxhetit fillestar të vitit 2021 e ka shfrytëzuar për 97.15%,ose 2.85% më pakë se buxheti fillestar dhe krahasuar me buxhetin e alokuar për periudhën raportuese është shpenzuar në masën 97.15% nga mjetete e dedikuara për tu shpenzuar.

3. DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PERSONELIT

Nr.	Emërtimi i	Shpenzuar	Buxheti Filles	Buxh Alokuar	Shpenzuar	Progresi	Progres	Progresi
Rd.	Shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	8=6:5
3.1	Pagat dhe Shtesat	183,295.17	182,224.14	182,224.14	182,224.14	99.42%	100.00%	100.00%
3.2	Mallrat & Sherbimet	153,906.40	156,000.00	156,000.00	155,002.00	100.71%	99.36%	99.36%
3.3.	Shpenzimet Kapitale	5,995.00	-	-	-	0.00%	#DIV/0!	#DIV/0!
3.3.	Mall & Shebimet THV.2021	69,965.57	94,000.00	94,000.00	93,721.14	133.95%	99.70%	99.70%
3.4.	Mall & Shebimet THV.2020	13,727.25	22,792.70	22,792.70	22,492.70	163.85%	98.68%	98.68%
	T O T A L :	426,889.39	455,016.84	455,016.84	453,439.98	106.22%	99.65%	99.65%

- Drejtoria e Administratës dhe Përsoneelit buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar për 6.22% më shumë,kurse sipas buxhetit fillestar të vitit 2021 ajo e ka shfrytëzuar në masën prej 99.65% ,e sipas buxhetit të alokuar për vitin raportues shfrytëzimi i buxhetit është 99.65% ose 0.35% më pakë se mjetet e alokuara për shpenzim.

➤ DREJTORIA E INSPKACIONIT



Nr	Emërtimi i	Shpenzuar	Buxheti Fille	Buxh.Alokuar	Shpenzuar	Progresi	Progresi	Progresi
Rd.	Shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	9=6:5
4.1	Pagat dhe Shtesat	71,058.13	64,777.29	64,777.29	64,777.29	91.16%	100.00%	100.00%
4.2	Mallrat & Sherbimet	9,046.91	10,000.00	10,000.00	8,668.26	95.81%	86.68%	86.68%
4.3	Shpenz.kapitale THV 2021	525.40	-	-	-	0.00%	#DIV/0!	#DIV/0!
4.4	Shpenz.kapitale THV 2020	4,969.00	11,140.37	11,140.37	1,129.40	22.73%	10.14%	10.14%
	T O T A L :	85,599.44	85,917.66	85,917.66	74,574.95	87.12%	86.80%	86.80%

- Drejtoria e Inspektionit buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar 87.12%, kurse sipas buxhetit fillestar ajo e ka shfrytëzuar në masën prej 86.60% e krahasuar sipas buxhetit të alokuar të vitit 2021 e ka shfrytëzuar në masën prej 86.80% ose 13.20% më pakë nga mjetet e destinuar për shpenzim.

➤ DREJTORIA PËR BUXHET EKONOMI E FINANCA

Nr.	Emërtimi i	Shpenzimet	Buxh.Fillest	Buxh.Alokuar	Shpenzimet	Progresi	Progres	Progresi
Rd.	Shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	%
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	9=6:5
5.1	Pagat dhe Shtesat	154,841.37	153,134.15	153,134.15	153,134.15	98.90%	100.00%	100.00%
5.2	Mallrat e Shërbimet	35,711.67	36,000.00	36,000.00	35,935.61	100.63%	99.82%	99.82%
5.3	Mall.&Shërbi.THV2021	4,350.92	10,000.00	10,000.00	3,911.49	89.90%	39.11%	39.11%
5.4	Mall.&Shërbi.THV2020	1,188.76	4,660.25	4,660.25	4,660.08	392.01%	100.00%	100.00%
	T O T A L :	196,092.72	203,794.40	203,794.40	197,641.33	100.79%	96.98%	96.98%

- Drejtoria për Buxhet Ekonomi e Financa, buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar për 0.79% më shumë, kurse sipas buxhetit fillestar të vitit 2021 e ka shfrytëzuar në masën prej 96.98% ose për 3.02% më pakë, ndersa sipas buxhetit të alokuar në periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2021 ajo e ka shfrytëzuar për 96.98% .

6. DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE, MBROJTJE CIVILE DHE EMERGJENCË

Nr.	Emërtimi i	Shpenzuar	Buxh.Filles	Buxh.Alokuar	Shpenzuar	Progresi	Progresi	Progres
Rd.	Shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	9=6:5
6.1	Pagat dhe Shtesat	202,421.00	165,720.14	165,720.14	165,720.14	81.87%	100.00%	100.00%
6.2	Mallrat & Sherbimet	52,146.84	60,000.00	60,000.00	59,859.98	114.79%	99.77%	99.77%
6.3	Shpenzimet Komunale	118,378.62	130,000.00	130,000.00	129,999.95	109.82%	100.00%	100.00%
6.4	Subvencione & transfere	65,000.00	58,000.00	58,000.00	58,000.00	89.23%	100.00%	100.00%
6.5	Shpenzimet Kapitale	3,437,062.71	2,806,540.00	2,806,540.00	2,754,427.41	80.14%	98.14%	98.14%
6.6	Mallrat & Sherb. THV 2021	15,557.88	35,000.00	35,000.00	35,000.00	224.97%	100.00%	100.00%
6.7	Shpenz.Komunale THV.2021	39,996.95	50,000.00	50,000.00	49,514.02	123.79%	99.03%	99.03%
6.8	Shpenzimet Kapit.THV.2021	406,300.03	515,156.00	515,156.00	405,335.81	99.76%	78.68%	78.68%
6.9	Mallrat & Sherb.THV 2020	-	18,442.15	18,442.15	18,429.40	#DIV/0!	99.93%	99.93%
7.1	Shpenz. Kapitale THV.2020	334,600.13	181,722.94	181,722.94	146,452.42	43.77%	80.59%	80.59%
	T O T A L :	4,671,464.16	4,020,581.23	4,020,581.23	3,822,739.13	81.83%	95.08%	95.08%

- Drejtoria e Shërbimeve publike ,mbrojtje civile dhe emergjencë,buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar për 81.83%,kurse sipas buxhetit fillestar të vitit 2021 e ka shfrytëzuar vetëm 95.08% ose 4.92% më pakë,ndërsa sipas buxhetit në alokuar – në periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2021, ajo ka arritur ta shpenzoi në masën prej 95.08%, 4.92% më pakë se mjetet e alokuara për vitin raportues.
- Mos realizimi i mjeteve të alokuara është si pasojë e mos shpenzimit të mjeteve për investime kapitale,deri sa **ato nga Granti Qeveritar janë shpenzuar në masen prej 98.14%.**Shpenzimet nga **mjetet vetanake kanë ngecur dhe atë nga fondi (21) vetëm 78.68%** nga mjetete alokuara,kurse nga **mjetet e bartuara fondi (22) vetëm 80.59% nga mjetet e dedikuara për shpenzim ose për 19.41% më pakë** se sa mjetet e alokuara për shpenzim për periudhën raportuese në mjetet e bartura.

➤ **ZYRA E KOMUNITETEVE PËR KTHIM**

nr rd	Emertimi Shpenzimeve	Shpenzuar I-XII/2020	Buxh.Fille I-XII/2021	Buxh.Alokua I-XII/2021	Shpenzuar I-XII/2021	Progresi në %	Progresi në %	Progresi në %
1	2	3	4	5	6	7=6/3	8=6/4	9=6/5
7.3	Paga & Meditje	6,123.66	6,220.70	6,220.70	6,220.70	101.58%	100.00%	100.00%
7.4	Mallra & Sherbime	1,814.96	2,000.00	2,000.00	2,000.00	110.20%	100.00%	100.00%
	Total:	7,938.62	8,220.70	8,220.70	8,220.70	103.55%	100.00%	100.00%

- Zyra e komuniteteve për kthim buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar për 3.55% më shumë,kurse sipas buxhetit fillestar të vitit 2021 e ka shpenzuar masën prej 100.00% .

8. DREJTORIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Nr Rd	Emërtimi i shpenzimeve	Shpenzuar I-XII/2020	Buxh.filestar I-XII/2021	Buxh.Alokuar I-XII/2021	Shpenzuar I-XII/2021	Progresi në %	Progresi në %	Progresi në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	9=6:5
8.1	Pagat & Meditjet	66,758.40	59,075.74	59,075.74	59,075.74	88.49%	100.00%	100.00%
8.2	Mallrat & Sherbimet	12,058.59	20,000.00	20,000.00	15,318.01	127.03%	76.59%	76.59%
8.4	Shpenzimet Kapitale	232,929.10	453,000.00	453,000.00	411,947.20	176.86%	90.94%	90.94%
8.5	Subv.& Transf. THV.2021	15,000.00	100,000.00	100,000.00	98,650.00	657.67%	98.65%	98.65%
8.6	Mallrat & Sherb. THV 2021	1,000.00	20,000.00	20,000.00	3,360.00	336.00%	16.80%	16.80%
8.7	Shpenz.Kap. THV.2021	69,521.40	67,800.00	67,800.00	35,960.90	51.73%	53.04%	53.04%
8.8	Mall. & Sherb. THV 2020	466.00	27,977.86	27,977.86	27,975.00	6003.22%	99.99%	99.99%
8.9	Subv.& Transf. THV. 2020	500.00	-	-	-	0.00%	#DIV/0!	#DIV/0!
9.1	Shpenz.Kap. THV.2020	5,784.00	44,701.11	44,701.11	42,335.00	731.93%	94.71%	94.71%
	TOTAL:	404,017.49	792,554.71	792,554.71	694,621.85	171.93%	87.64%	87.64%

- Drejtoria e Bujqësisë,Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural,buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 202, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar për 71.93% më shumë,kurse sipas buxhetit fillestar të vitit 2021 e ka shfrytëzuar 87.64%,ndërsa sipas buxhetit të alokuar në periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2021, ajo e ka shfrytëzuar në masen prej 87.64% ose për 12.36% më pakë se periudha raportuese.

9. DREJTORIA PËR URBANIZËM DHE PLANIFIKIM

Nr	Emërtimi i	Shpenzuar	Buxh.filestar	Buxh.Alokuar	Shpenzuar	Progresi	Progresi	Progresi
Rd	shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	9=6:5
8.1	Pagat dhe Shtesat	41,177.11	37,653.26	37,653.26	37,653.26	91.44%	100.00%	100.00%
8.2	Mallrat & Sherbimet	15,910.00	15,000.00	15,000.00	13,869.08	87.17%	92.46%	92.46%
8.3	Shpenzimet Kapitale	274,803.38	155,000.00	155,000.00	154,998.35	56.40%	100.00%	100.00%
8.4	Mallrat & Sherb.THV.2021	4,861.80	15,000.00	15,000.00	13,748.47	282.79%	91.66%	91.66%
8.5	Shpen.Kapitale THV 2021	-	25,000.00	25,000.00	-	#DIV/0!	0.00%	0.00%
8.6	Mallrat & Sherbimet THV 2020	-	6,138.20	6,138.20	957.00	#DIV/0!	15.59%	15.59%
8.7	Shpenz.Kap.THV.2020	15,650.00	91,509.07	91,509.07	33,559.72	214.44%	36.67%	36.67%
	TOTAL:	352,402.29	345,300.53	345,300.53	254,785.88	72.30%	73.79%	73.79%

- Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar për 72.30%, kurse sipas buxhetit fillestar të vitit 2021 e ka shfrytëzuar për 73.79% ose 26.21% më pakë, ndërsa sipas buxhetit të alokuar në periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021 ajo buxhetin e ka shfrytëzuar në masën prej 73.79% .

10. DREJTORIA PËR KULTURË, RINI, SPORT E MËRGATË

Nr.	Emërtimi i	Shpenzuar	Buxheti Filles	Buxheti Alokuar	Shpenzuar	Progresi	Progresi	Progresi
Rd.	shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	8=6:5
10.1	Paga dhe Shtesa	81,785.18	80,982.23	80,982.23	80,982.23	99.02%	100.00%	100.00%
10.2	Mallra & Sherbime	13,996.26	35,000.00	35,000.00	34,045.79	243.25%	97.27%	97.27%
10.3	Subv.& Transfere 2020	40,000.00	-	-	-	0.00%	#DIV/0!	#DIV/0!
10.4	Shpenzimet Kapitale	270,655.33	145,000.00	145,000.00	144,603.96	53.43%	99.73%	99.73%
10.5	Mallra & Sherb.THV 2021	7,976.59	27,000.00	27,000.00	14,145.91	177.34%	52.39%	52.39%
10.6	Subv.& Trans.THV 2021	80,000.00	100,000.00	100,000.00	100,000.00	125.00%	100.00%	100.00%
10.7	Shpenz.Kap.THV.2021	21,908.19	60,000.00	60,000.00	21,394.20	97.65%	35.66%	35.66%
10.8	Subv.& Trans.THV 2020	-	80,000.00	80,000.00	80,000.00	#DIV/0!	100.00%	100.00%
10.9	Shpenz.Kap.THV.2020	12,094.45	58,296.07	58,296.07	26,599.46	219.93%	45.63%	45.63%
	TATAL:	528,416.00	586,278.30	586,278.30	501,771.55	94.96%	85.59%	85.59%

- Drejtoria e Kulturës, Rinisë Sportit dhe Mërgatës buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar për 94.96%, kurse sipas buxhetit fillestar të vitit 2021 e ka shfrytëzuar në masën prej 85.59%, ndërsa sipas buxhetit të alokuar në periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, e ka shfrytëzuar në masën prej 14.41% më pakë se buxheti alokuar për këtë njësi buxhetore për shpenzim.

11. DREJTORIA PËR SHËRBIME PRONËSORE JURIDIKE DHE KADASTËR

Nr	Emertimi i	Shpenzuar	Buxh.Fillestar	Buxh.Alokuar	Shpenzuar	progresi	progresi	progresi
Rd	Shpenzimeve	I-XII/2020	I-XII/2021	I-XII/2021	I-XII/2021	në %	në %	në %
1	2	3	4	5	6	7=6:3	8=6:4	9=6:5
11.1	Pagat & Meditjet	70,717.54	64,819.41	64,819.41	64,819.41	91.66%	100.00%	100.00%
11.2	Mallra & Sherbime	8,968.29	9,000.00	9,000.00	8,522.88	95.03%	94.70%	94.70%
11.3	Mallra & Sher.THV 2021	430.43	5,000.00	5,000.00	5,000.00	1161.63%	100.00%	100.00%
11.4	Mall. & Sherb.THV 2020	712.40	-	-	-	0.00%	#DIV/0!	#DIV/0!
	TOTAL:	80,828.66	78,819.41	78,819.41	78,342.29	96.92%	99.39%	99.39%

- Drejtoria për Shërbime Pronësore Juridike dhe Kadastër, buxhetin për periudhën Janar- Dhjetor të vitit 2021, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2020 e ka shfrytëzuar për 96.92% ,kurse sipas buxhetit fillestar ajo e ka shfrytëzuar në masën prej 99.39% kurse sipas buxhetit të alokuar për vitin 2021 ajo e ka shfrytëzuar në masën prej 99.39% ose për 0.64% më pakë se mjetet e dedikuara për shpenzim.

12. DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENJE SOCIALE

